

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Rahovecit z. Qazim Qeska**

I nderuari z. Qeska,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7-12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- 50 Milion Euro investime në katër vitet e ardhshme, premtim ky i Kryeministrit Thaçi;
- Për fshatrat Drenaj, Rudinë dhe Frashër: sigurimi i ujit, kanalizimit, rinovimi i rrjetit elektrik dhe ndriçimi publik;
- Status të veçantë për Krushën e Madhe;
- Investime në infrastrukturë dhe ndërtimin e një nënkalimi në rrugën magjistrale Prizren – Gjakovë;
- Investime në shëndetësi;
- Rregullimin e trotuareve prej Krushës deri në Rahovec;
- Rregullimin e semaforëve .

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)